



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL / SKUPŠTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY
SHTIME / ŠTIMLJE



Data/Datum/Date:	19.01.2023
Nr./Br./No	07/2
Për/Za/To:	Kuvendi i Komunës së Shtimes
Përmes/Preko/Through:	Kryetarit të Komunës z.Qemajl Aliu
Nga/Od/From:	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale z.Isa Haxhiu
Lënda/Predmet/Subject :	Propozim-Vendim për ndarjen nga 100€ për Nënat-Lehona për ç'do fëmijë të lindur në vitin 2023



I

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d), Nenin 17 pika (k), dhe Nenin 24, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008);
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, i propozon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të merr vendim për ndarjen nga 100€ të specifikuar për destinimin e veçantë për Nënat-Lehona për çdo lindje të fëmijut në vitin 2023, si dhe për fëmijët e lindur në vitin 2022 që nuk kanë pas mundësi me aplikuar, në vitin 2022, për banorët e Komunës së Shtimes.

II

A r s y e t i m: Propozim-Vendimi për ndarjen nga 100€ për ç'do fëmijë të lindur gjatë vitit 2023 është propozuar duke marrë parasysh, zotimet tona për ti ndihmuar kësaj kategorie. Po ashtu jemi bazuar në rritjen e Buxhetit të Komunës së Shtimes në programin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale pika 4 (Subvencione dhe Transfere) nga 55,234 € në vitin 2022, në shumën prej 132,734 €, në vitin 2023. Drejtoria ka pasë parasysh edhe faktin se është mirëpritur shumë nga të gjitha përfitueset Nënate Lehona që kanë pranuar 100 € për lindje të fëmijut gjatë vitit 2022.